



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Kllokot/Opština Klokot/Municipality of Klokot**

**Drejtoria per Arsim,Shendetesi ,Sherbime Sociale,Kulture,Rini dhe Sport**

**Nr \_\_\_\_\_**

**Me 22.07.2011**

**Kllokot**

**Per**

**Kuvendin e Komunes**

**Lenda:**

**Dreft dokument mbi Termat e References per punen e Komitetit Lokal tew Veprimit(KLV) per eliminimin e punes se ndaluar me Ligj te femijeve**

Duke u bazuar në memorandumun e mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në rolin udhëheqës të Komitetit Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve, i themeluar me vendimin 5/166 të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës, me qëllim të zyrtarizmit të Procesit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Komunën tuaj si një bazë strategjike drejt Parandalimit dhe Eliminimit të Punës së Fëmijëve si dhe Krijimin e strukturave lokale për MPF, Kryetarit i Komunës aprovon:

## **Termat e Referencës**

**Për**

**Komiteti Lokal i Veprimit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve**

**Neni 1.**

**Roli i KLV-ve për Monitorimin e Punës së Fëmijëve**

Komiteti Lokal i Veprimit zbaton drejtpërdrejt politikë dhe prioritetë programore për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës

## **Neni 2. Funksioni i KLV**

### **Komiteti Lokal i Veprimit ka Funksionet Vijuese:**

1. Implementon procesin e MPF në nivel lokal dhe Monitoron situatën e punës së fëmijëve në komunën përkatëse
2. Në vazhdimësi dokumenton trendët e shtrirjes së punës së fëmijëve në komunën përkatëse
3. Planifikon veprime për parandalim dhe eliminim e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në at komunë .
4. Bën vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të masave ekzistuese në nivelin lokal edhe përmes rekomandimeve dhe udhëzimeve propozon asamblesë komunale në nivelin lokal dhe KKPEPF përmes GTP- IPS në nivelin qendror veprime konkrete dhe zhvillim/avancim të vazhdueshëm të politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes.

## **Neni 3.**

### **Krijimi dhe përbërja e KLV**

1. Komiteti Lokal i Veprimit mbi Monitorimin e Punës së Fëmijëve është themeluar sipas strukturës së propozuar në kuadër të Profilit Kosovar për MPF.
2. Anëtarët e Komitetit Lokal të Veprimit janë Zyrtarë të Lartë të Autoriteteve Lokale, përfaqësues të institucioneve qendrore, përfaqësues të partnerëve social dhe të shoqërisë civile.
3. Anëtarët e KLV do të trajnohen nga trajnues kompetent mbi monitorimin e punës së fëmijëve mbi procedurat standarde të veprimit në kuadër të procesit të MPF. dhe do të certifikohen nga MPMS-IPS
4. Udhëheqës i Komitetit Lokal të Veprimit për MPF është Drejtori i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
5. Anëtar të Komitetit Lokal i Veprimit për MPF janë zyrtarët e lartë të institucioneve vijuese:
  - 1) Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale- Udhëheqësi i sektorit (qendrave të mjekësisë familjare)

- 2) Drejtoria Komunale e Arsimit- Udhëheqësi sektorit të arsimit fillor dhe të mesëm (si dhe I shkollave profesionale nëse është sektor I ndare)
- 3) Drejtoria Komunale e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-
- 4) Drejtoria Komunale e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Zyrtari për Rini
- 5) Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës- Inspektori i punës që vepron në komunën
- 6) Qendra për Punë Sociale- Udhëheqësi i SHS dhe Udhëheqësi i SAS
- 7) Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave- Mbrojtësi i viktimës për komunën përkatëse
- 8) Shërbimi Sprovues- Zyrtari i shërbimit sprovues
- 9) Policia e Kosovës- Njësia e Bashkësisë
- 10) Policia e Kosovës - Njësia kundër dhunës në familje
- 11) Policia e Kosovës - Njësia kundër trafikim
- 12) Zyra e Punësimit
- 13) Qendra e Aftësimit Profesional
14. Dega përkatëse e OEK
15. Dega përkatëse e BSPK-së
16. Dega përkatëse e SBASHK-ut
17. OJQ ( aktive në mbrojtjen e fëmijëve)
18. Këshilli i veprimit rinor
19. Këshilli komunal prind arsimtar
20. Asambleja komunale e fëmijëve

#### **Neni 4**

#### **Kompetencat e KLV**

1. Komiteti Lokal i Veprimit mblidhet gjatë vitit të par një herë në muaj, ndërsa pas një viti çdo 3 muaj në takimet e rregullta apo më shpesh në takime të jashtëzakonshme , nëse iniciohen nga anëtarët ose nëse thirren nga udhëheqësi për të a/ shqyrtuar të dhënat e konsoliduar nga QPS-të dhe parterët tjerë b/ shqyrtuar mundësitë dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave që kanë të bëjnë me eliminimin e PF. c/ Informatat për shkeljen e ligjeve lidhur me punën e fëmijëve a i janë vënë në dispozicion nëpunësve zbatues të ligjit dhe të sistemit ligjor.
2. Komiteti Lokal i Veprimit do të siguroj që të gjithë partnerët e përfshirë në MPF të mbajnë shënime për veprimet e ndryshme në MPF të zbatuara nga ata (p.sh. shkollat, qendrat shëndetësore, inspektorët e punës, policia në bashkësi do të mbajnë shënime mbi fëmijët e referuar nga vet ata në QPS, ofruesit e shërbimeve do të mbajnë shënime për shërbimet e ofruara, etj.).
3. Komiteti Lokal i Veprimit merr vendime me votimin e së paku një më tepër se gjysma e anëtarëve të Komitetit
4. Komiteti Lokal i veprimit mund të formoj grupe punuese për nevoja të monitorimit të punës së fëmijëve



5. Komiteti lokal i veprimit harton planin vjetor të veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve për komunën përkatëse duke përfshirë edhe koston financiare i cili duhet të aprovohet nga asambleja komunale

#### **Neni 5**

#### **Pjesëmarrja në takimet e KLV**

1. Anëtarët e rregullt të Komitetit lokal të veprimit e kanë të obliguar pjesëmarrjen në takimet e KLV
2. Komiteti Lokal i Veprimit mund të ftoj në takimet e veta përfaqësues të institucioneve të ndryshme; OQ dhe OJQ si dhe nga komuniteti varësisht nga vlerësimi i nevojave
3. Për të përmbushur përgjegjësin e vet KLV mund të kërkoj këshillime dhe mbështetje profesionale nga IPS-GTP për MPF

#### **Neni 6.**

#### **Sekretaria e KLV**

1. Çdo udhëheqës i KLV mund të caktoj një koordinator i cili do të ketë rolin e sekretarisë së KLV
2. Koordinator i KLV do të veproj në emër të udhëheqësit të KLV-së

#### **Neni 7.**

#### **Mënyra e raportimit**

1. Komiteti lokal i Veprimit konsolidon raportin mbi situatën e punës së fëmijëve në baza të raporteve nga partnerët në nivelin lokal për komunën përkatëse në baza gjashtë mujore dhe i dorëzon IPS-njesisë së punës, përmes formave standarde të raportimit duke përfshirë edhe a/vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese në nivelin lokal për periudhën e caktuar dhe b/rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe zhvillim/avancim të politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes
2. Raportet e konsoliduar dhjetor – maj duhet ti dorëzohen IPS – njesisë së punës ma së largu deri me datën 1 Qershor me qëllim që këtë hapësirë për

përpunimin e të dhënave për tu paraqitur raport i përpunuar nga të gjitha komunat nga IPS me 12 qershor në Ditën Botërore Kundër Punës së fëmijëve

3. Ndërsa raporti qershor dhjetor ma së largu deri me 1 dhjetor me qëllim të hartimit të raportit vjetor për prezantim KKPEPF

### **Neni 8 Përkrahësit e KLV**

1. Grupi Teknik Punues mbi MPF dhe Instituti për Politika Sociale kanë përgjegjësi për ngritjen e kapaciteteve, inicimin, përkrahjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të strukturave lokale të MPF-së.
2. Njësia e Punës së Fëmijëve do të ketë rolin e përkrahjes teknike dhe sigurimin e rrjedhjes së informatave nga niveli lokal në atë qendror dhe anasjelltas
3. Të gjithë anëtarët e KLV-së do të pajisen nga IPS me materialet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës si janë:
  - a) Lista e punëve të rrezikshme të fëmijëve në Kosovë për ndalim të Menjëhershëm
  - b) Udhëzimi Administrativ 17/2008 për parandalimin dhe Eliminimin e formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë
  - c) .Doracaku për trajner
  - d) Format standarde të raportimit



**Drejtori i Drejtorise:**

*Momqillo Stojković*